

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6426
E mërkurë, 29 shtator 2021
çmimi 0.40 €

Koncept-dokumenti
për vetingun dërgohet
në qeveri | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DIALOGU NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË VAZHDON SOT NË BRUKSEL | FAQE 4-5

BLLOKADA VAZHDON NË VERI, KOSOVA DHE SERBIA I KTHEHEN DIALOGUT

Kosova dhe Serbia sot (e mërkurë) në Bruksel pritet të diskutojnë për situatën në veri të Kosovës. Në bisedimet për shtensionimin e situatës në veri, pasi Kosova ka filluar zbatimin e masës së reciprocitetit për targa nga Serbia, pritet të marrë pjesë edhe zëvendësndihmëssekretari i Shtetit për Evropën Jugore dhe Qendrore, Gabriel Escobar. Diplomatat perëndimorë presin që ky takim ndërmjet palëve të ndihmojë për uljen e tensioneve



AKTUALE




SHKATËRROHET NJË RRJET I
DROGËS NGA BALLKANI | F.2

1 500 EURO PËR FAMILJET QË
KANË HUMBUR FAMILJARI NGA
COVIDI | F.3

NIS FUSHATA SENSIBILIZUESE PËR
PUNËSIM NË POLICINË E KOSOVËS | F.6

EKONOMI



BLLOKADA UL IMPORTIN E
MALLRAVE NGA SERBIA | F.7

ARBITRAZHI RREZIKON
BUXHETIN E SHOIPËRISË | F.7

SPORT



PËRURORHET QENDRA NACIONALE
E XHUDOS NË PEJË | F.12

KOMISIONI EVROPIAN MBËSHTET 'BALLKANIN E HAPUR'

FAQE 2



SBASHK-U:
PUNËTORËT ARSIMORË
ME SËMUNDJE TË
RËNDA TË LIROHEN
NGA OBLIGIMI PËR
PARAQITJE NË PUNË

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Komisioni Evropian mbështet “Ballkanin e hapur”

Presidentja e Komisionit Evropian (KE), Ursula von der Leyen, ka vizituar të martën Shqipërinë. Ajo nga Fushë-Kruja, ku ka mbajtur konferencën e përbashkët me kryeministrin Edi Rama, ka dhënë një mesazh të qartë se mbështet procesin e “Ballkanit të hapur”, ndërkaq ka thënë se shpreson që Shqipëria të ulet në tryezë me BE-në para fundit të vitit për ta nisur procesin e negociatave për anëtarësim

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

TIRANË, 28 SHTATOR - Presidentja e Komisionit Evropian (KE), Ursula von der Leyen, gjatë vizitës së saj zyrtare në Tiranë të martën, ka thënë se KE-ja mbështet çfarëdo iniciative që është brenda Procesit të Berlinit duke vënë theksin tek iniciativa “Ballkani i hapur”, e njohur më parë si Minishengeni Ballkanik.

Në konferencën e përbashkët për media me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, ajo ka theksuar se “Ballkani i hapur” duhet të jetë një proces i hapur, gjithëpërfshirës dhe që thellon bashkëpunimin ekonomik mes vendeve të rajonit. “Mendoj që po shohim ecurinë ekonomike dhe thellimin e marrëdhënieve ekonomike si dhe tregun e përbashkët rajonal. Mendoj se procesi i Berlinit po e shtyn procesin e integritit para, si kuadër në të cilin gjashtë vendet e rajonit do të përfitojnë. Çdo iniciativë që është brenda procesit të Berlinit dhe që sjell bashkëpunimin, mirëpritet prej nesh”, ka thënë Ursula von der Leyen.

Ndërsa kryeministri Rama ka

thënë se shtetet që ende nuk kanë pranuar të bëhen pjesë e kësaj iniciative do t'i bashkohen herët a vonë. “‘Ballkani i hapur’ është vendosur të bëhet dhe çdo vit e më shumë do të provohet që është gjëja e duhur. ‘Ballkani i hapur’ do të jetë patjetër hapësira ku do të vijnë (Kosova, Mali i Zi dhe Bosnjë e Hercegovina), njëri pak më shpejt, tjetri pak më vonë. Dhe kush vjen më vonë, thjesht i humbet kohë vendit dhe popullit të vet. Kaq e thjeshtë është kjo”, ka deklaruar Rama, duke shtuar se kjo iniciativë është një interes strategjik. Ideja e Minishengenit Ballkanik u paraqit në Novi Sad të Serbisë më 10 tetor të vitit 2019 nga



liderët e Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë. Tre liderët, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, ai shqiptar, Edi Rama dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në kuadër të forumit, nënshkruan dy memorandume dhe një marrëveshje ndërshtetërore, që ka për qëllim lehtësimin e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave me qëllim të forcimit të mëtejshëm të

bashkëpunimit ekonomik. Ursula von der Leyen gjatë vizitës së saj në Tiranë foli edhe për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duke thënë se e ardhmja e Shqipërisë është në Bashkimin Evropian. Ajo ka theksuar se Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut meritojnë të jenë në BE dhe për këtë nuk ka asnjë pikë dyshimi. “Unë jap mbështetjen time të plotë për të ecur përpara për negociatat e

anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut sa më shpejt që të jetë e mundur. Që të fillojnë bisedimet për anëtarësim, ne kemi biseduar që në të shkuarën dhe po vazhdojmë të punojmë fort për këtë gjë dhe dua shumë që ky proces të ecë përpara që të fillojmë përpara fundit të vitit”, ka deklaruar Ursula von der Leyen.

Në anën tjetër, Rama ka pohuar se procesi i anëtarësimit nuk varet më nga Shqipëria. “Nuk vë bast më për asnjë datë apo afat. Jemi përgatitur shumë herë për dasmë dhe krushqit nuk janë paraqitur. Është e qartë. Ne kemi në dorë të bëjmë punën tonë dhe jo se na e imponon Brukseli, por se na e imponon e ardhmja e fëmijëve. Hapen nuk hapen, kjo është një çështje e BE-së dhe nuk është as e komisionit, madje as e këtyre, po e një anëtari të BE-së që gdhiet me nerva me fqinj”, ka thënë Rama.

Shqipëria në tryezë me BE-në para fundit të këtij viti

Presidentja e KE-së, Ursula von der Leyen, ka thënë se shpreson që Shqipëria të ulet në tryezë me BE-në para fundit të vitit për të nisur procesin e negociatave për anëtarësim. “Ne kemi punuar fort për hapjen e kësaj konference të

parë ndërqeveritare dhe dua të ritheksoj faktin që keni kryer detyrat tuaja dhe do të bëjmë gjithçka që është e mundur që t'i kapërcejmë pengesat. Shpresoj shumë që të mund të fillojmë konferencën e parë ndërqeveritare para fundit të

këtij viti. Ky është synimi ynë”, ka deklaruar Leyen. Ndërsa kryeministri Edi Rama ka thënë se tani nuk kanë më përgatitje për dasmë, por vetëm deklarata dashurie, sepse dasmën e kanë në dorë krushqit.

Shkatërrohet një rrjet i drogës nga Ballkani



HAGË, 28 SHTATOR - Agjencitë për zbatimin e ligjit nga tetë vende evropiane kanë shkatërruar një kartel të drogës nga Ballkani, duke akuzuar 61 persona.

Gjatë operacionit janë konfiskuar më shumë se 2.6 tonë kokainë.

Agjencia evropiane e policisë, Europol, ka njoftuar se më 27 shtator se ky kartel kishte “përmbitur Evropën me kokainë”. Transporti i drogës për në Evropë bëhej nga Amerika e Jugut përmes Spanjës.

Në këtë operacion ndërkombëtarë u angazhuan agjencitë e sigurisë nga Serbia,

Bosnje dhe Hercegovina, Sllovenia, Kroacia, Spanja, Gjermania, Shtetet e Bashkuara dhe Kolumbia. “Kjo organizatë kriminale përbëhej kryesisht nga kriminelë serbë, kroatë, malazezë dhe sllovenë si dhe kishte një rrjet të shtrirë në disa vende”, ka njoftuar Europol.

Gjatë disa muajve agjencitë e policisë mbledhën informacione duke bërë që autoritetet spanjolle në muajin mars të bastisnin disa qytete dhe të arrestonin 13 individë, përfshirë një oficer policie që punonin me kartelin. Atëbotë ata po përgatiteshin për të pranuar një dërgesë droge nga

Amerika e Jugut.

Operacioni kishte vazhduar edhe në muajin maj, kur 48 pjesëtarë të grupit kriminal ishin akuzuar në Slloveni. Ata akuzoheshin për shpërndarje të kokainës dhe marijuanës në të gjithë Evropën. Dhjetë nga të dyshuarit janë nën arrest.

Gjatë aksionit për shkatërrimin e kësaj bande kriminale janë sekuestruar 2.6 tonë kokainë dhe 324 kilogramë marijuanë, si dhe makina luksoze dhe gati 700 000 dollarë në para të gatshme. Europol nuk bëri me dije se pse e bëri njoftimin disa muaj pasi është zhvilluar operacioni.

1 500 euro për familjet që kanë humbur familjarin nga Covidi

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka operacionalizuar të martën masën 3.1 për mbështetjen e familjeve që kanë humbur anëtarin e familjes nga Covid-19. Kjo ministri ka njoftuar se aplikimi do të mund të bëhet online duke plotësuar formularin në vijim: <https://masa3-1.rks-gov.net>. "Aplikimi do të jetë i hapur deri më 30 nëntor 2021 dhe, përveç detajeve personale të aplikuesit dhe familjarit që ka

humbur jetën, nevojitet edhe kopja e skanuar/fotografuar e letërnjoftimit dhe certifikata civile që dëshmon lidhjen familjare të aplikuesit me familjarin që ka humbur jetën", ka njoftuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Kjo ministri ka njoftuar se shuma e mbështetjes për aplikimet që përmbushin kriteret do të jetë 1 500 euro pagesë e njëhershme, ndërsa mbështetje e veçantë do të jetë për personelin shëndetësor të institucioneve publike që kanë humbur jetën në luftën e tyre me pandeminë.

Sipas këtij njoftimi, të drejtë aplikimi kanë vetëm anëtarët e familjes së ngushtë (bashkëshorti/ja, fëmija, ose prindi) për familjarin e vdekur nga Covid-19. "Konfirmimi do të bëhet me listën e vdekjeve të konfirmuara prej Covid-19 nga IKShPK. Për ata që humbin familjarin pas datës 1 tetor 2021, parakusht për kualifikim për mbështetje do të jetë edhe vaksinimi me dy doza të vaksinës anti-Covid i personit që ka humbur jetën", ka njoftuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.



SBASHK-u: Punëtorët arsimorë me sëmundje të rënda të lirohen nga obligimi për paraqitje në punë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Për të vlerësuar se si ka nisur viti i ri shkollor, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) ka mbajtur takim me kryetarët e nivelit komunal sindikal.

Pjesëmarrësit e këtij takimi kanë dhënë vlerësime lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor në komunat e tyre, duke u shprehur se ishte një fillim i

suksesshëm dhe se punëtorët arsimorë do të angazhohen me përkushtim për rrjedhën e mbarë të vitit të ri shkollor. Pas kësaj kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i ka informuar pjesëmarrësit lidhur me takimin me zëvendësministrin Dukagjin Popovci duke veçuar se temë kyçe e bisedës ka qenë përgatitja për fillimin e vitit të ri shkollor. Ai ka thënë se SBASHK-u edhe në këtë takim kishte insistuar që të bëhet një zgjidhje e

pranueshme për punëtorët me sëmundje të rënda. "Në këtë drejtim nuk është marrë përgjegjësi meritore dhe SBASHK-u i drejtohet kryeministrit Kurti me kërkesën që Qeveria e Kosovës ta vë në rend dite këtë çështje dhe të sjellë vendim që punëtorët arsimorë me sëmundje të rënda të lirohen nga obligimi për të shkuar në punë, të mbesin në listat e pagave dhe në vend të tyre të angazhohen kuadro të reja", ka thënë Jasharaj.

Tetë vdekur dhe mbi 3 000 raste aktive me Covid në Kosovë



PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të martën janë regjistruar tetë viktima nga Covid-19. Sipas MSh-së, në 24 orët e fundit janë regjistruar edhe 68 persona të infektuar me këtë virus, pas testimit të 4 320 mostrave. Këto shifra nënkuptojnë se 1.5 për qind e personave të testuar kanë

rezultuar pozitivë. Sipas autoriteteve, 323 persona janë shëruar, kurse mbi 3 342 persona janë ende aktivë me Covid-19. Prej shpërthimit të pandemisë në mars të vitit 2020, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar mbi 159 000 raste të infektimit. Prej këtyre, 2

947 persona kanë vdekur. Prej nisjes së fushatës së vaksinimit, 513 544 persona janë vaksinuar plotësisht kundër këtij virusi, ndërsa 785 938 persona kanë marrë dozën e parë. Deri më 28 shtator në orën 15:00 është vaksinuar plotësisht 28.5 për qind e popullsisë së përgjithshme.

50 000 euro ndahen donacion për procesin e vaksinimit në Kosovë

PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Bankat anëtare të Shoqatës së Bankave të Kosovës kanë nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me Ministrinë e Shëndetësisë përmes së cilës bankat kanë ndarë shumën prej 50 000 eurosh për ta mbështetur procesin e vaksinimit në Kosovë. "Duke qenë se vaksinimi është përgjigja në luftën kundër

pandemisë, të gjithë duhet të bëjmë më shumë për të mbështetur këtë proces", është shprehur kryeshefi ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija. Ndërkaq Drin Podrimqaku, këshilltar politik i ministrit Vitia, ka thënë se si Ministri e Shëndetësisë janë shumë mirënjohës për mbështetjen e vazhdueshme që sektori

bankar po jep për ta luftuar pandeminë.

Faik Hoti, udhëheqës i Divizionit të Komunikimit me Publikun në Ministri të Shëndetësisë, ka theksuar se ky donacion do të pranohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe do të vendoset në dispozicion të personelit mjekësor dhe vullnetarëve të ekipeve të vaksinimit në Kosovë.





DIALOGU NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË VAZHDON SOT NË BRUKSEL

Blokada vazhdon në veri, Kosova dhe Serbia i kthehen dialogut

Kosova dhe Serbia sot (e mërkurë) në Bruksel pritet të diskutojnë për situatën në veri të Kosovës. Në bisedimet për shtensionimin e situatës në veri, pasi Kosova ka filluar zbatimin e masës së reciprocitetit për targar nga Serbia, pritet të marrë pjesë edhe zëvendësndihmëssekretari i Shtetit për Evropën Jugore dhe Qendrore, Gabriel Escobar. Diplomatat përëndimorë presin që ky takim ndërmjet palëve të ndihmojë për uljen e tensioneve

EPOKA ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Pas shumë thirrjeve nga bashkësia ndërkombëtare, Kosova dhe Serbia do t'i kthehen tavolinës së bisedimeve në Bruksel. Përfaqësuesit e Republikës së Kosovës dhe ata të Serbisë sot (e mërkurë) pritet të takohen në Bruksel për të diskutuar për situatën në veri, e cila është tensionuar pasi Qeveria e Kosovës ka vendosur masën e reciprocitetit për targar nga Serbia.

Në takimin që do të ndërmjetësohet nga i dërguar i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, do të marrin pjesë shefi i grupit

negociator i Kosovës dhe ai i Serbisë, zëvendëskryeministri Besnik Bislimi dhe Petar Petković, shef i së ashtuquajturës Zyra Serbe për Kosovën.

Në bisedimet e Brukselit pritet të marrë pjesë edhe zëvendësndihmëssekretari i shtetit për Evropën Jugore dhe Qendrore, Gabriel Escobar. "Ne mbështesim propozimin e BE-së për të organizuar diskutime këtë javë, mbi këtë çështje dhe të tjera. Inkurajojmë Kosovën dhe Serbinë që të riangazhohen në mënyrë të hapur, serioze dhe të menjehershme. Zëvendësndihmëssekretari i Departamentit të Shtetit për Çështjet Evropiane dhe

Euroaziatike, Gabriel Escobar, do të udhëtojë në Bruksel këtë javë që të marrë pjesë në këto bisedime", ka deklaruar për media Ambasada Amerikane e ShBA-së në Kosovë.

Thirrjet e përfaqësuesve të BE-së, që tensionet e fundit të zgjidhen me dialog, nuk kanë munguar as të martën. Kryetarja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, e cila ka zhvilluar një vizitë në Tiranë, ka thënë se situata është shumë shqetësuese dhe se të dyja vendet duhet t'i ulin tensionet e të rikthehen në dialog. "Keni punuar për çështjen e bashkëpunimit dhe keni pasur arritje. Rritja e tensioneve Kosovë - Serbi është shqetësuese dhe është thelbësore të ulët tensioni dhe të rikthehen në dialog. Edhe BE-ja u ndërtua në bazën e dialogut dhe më pas në bazën e zhvillimit ekonomik. Ky është një proces i gjatë që sjell një të ardhme me paqe dhe begati", ka thënë von der Leyen në një konferencë për media.

Të martën edhe disa deputetë të Parlamentit Evropian, që janë raportues për vendet e Ballkanit Perëndimor, u kanë bërë thirrje

Kosovës dhe Serbisë të gjejnë një zgjidhje paqësore dhe të qëndrueshme për situatën në veri. "Dëshirojmë që ta shohin tërheqjen e njëjësive speciale të policisë dhe çfarëdo formacione ushtarake dhe heqjen e bllokadave të rrugëve", është thënë në deklaratën e përbashkët të raportueses për Kosovën, Viola von Cramon-Taubadel, raportuesit për Serbinë, Vladimir Bilçik, udhëheqësit të delegacionit për raportet midis Kosovës dhe Bosnje e Hercegovinës, Romeo Franz dhe Tanja Fajon, që kryeson delegacionin për raportet me Serbinë në Parlamentin Evropian.

Eurodeputetët, po ashtu, kanë kërkuar që të ndalen veprimet dhe provokimet në atë pjesë. "Kërkojmë nga Bashkimi Evropian dhe partnerët e tij që të vazhdojnë punën drejt shtensionimit të krizës dhe i ftojme liderët e Kosovës dhe të Serbisë ta përdorin platformën që ofron dialogu i lehtësuar nga BE-ja për t'i zgjidhur të gjitha çështjet e hapura, përfshirë edhe ato që lidhen me lirinë e lëvizjes", është thënë në deklaratën e përbashkët.

Serbët refuzuan zëvendësimin e njëjësive speciale me KFOR-in

Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka bërë me dije se kryetarët e komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës kanë refuzuar një plan të paraqitur nga misioni i KFOR-it që kishte për qëllim shtensionim të situatës.

Në një konferencë për media, pas takimit me homologun e tij austriak Karl Nehammer, ai ka thënë se misioni i Aleancës Veri-atlantike në Kosovë (KFOR) ka ofruar që të sigurojë pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak. "Duke qenë se KFOR-i ka ofruar angazhime shtesë dhe ka ofruar që të sigurojë policinë tonë kufitare me forca shtesë edhe në pikat kufitare, ne kemi thënë se me largimin e barrkadave prania e njëjësive speciale do të ishte e panevojshme. Por, edhe kjo ofertë e komandantit të KFOR-it është refuzuar nga këto elemente ekstremiste dhe me këtë refuzim këta veçse e kanë dëshmuar që nuk janë të brengosur, siç thoshin më herët, me praninë e forcave speciale,

Kosova e gatshme të fillojë të japë dozën e tretë të vaksinës

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Vendimi për aplikimin e dozës së tretë të vaksinës kundër sëmundjes Covid-19 në Kosovë do të merret në kohën e duhur dhe bazuar në situatën epidemiologjike, thonë për "Radion Evropa e Lirë", zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës.

Se qytetarët e Kosovës duhet të marrin edhe dozën shtesë kundër Covid-19 e thotë profesori në Fakultetin e Mjekësisë, Sali Ahmeti dhe Hana Xhemaili, specialiste për hulumtime të politikave globale shëndetësore.

Doza përforcuese e vaksinës është rekomanduar edhe nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës. "Vendimi për aplikimin e dozës së tretë do të merret në kohën e

duhur dhe në përputhje edhe në rekomandimet e organizatave kredibile ndërkombëtare të fushës së shëndetësisë, parashikimet rreth situatës epidemiologjike dhe ecurisë së vaksinimit kundër Covid-19 në Kosovë", thuhet në përgjigjen e Ministrisë së Shëndetësisë dërguar REL-it.

Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) ka njoftuar më 23 shtator se në fillim të muajit tetor do të vendosë nëse do të miratojë dhënien e dozës shtesë të vaksinës Pfizer/BioNTech kundër Covid-19 për të gjithë njerëzit e moshës mbi 16 vjeç.

Pavarësisht se rregullatori evropian ende nuk e ka miratuar dozën e tretë të vaksinës, disa vende të Bashkimit Evropian po u

ofrojnë qytetarëve të tyre një mundësi të tillë. Një proces të tillë tashmë kanë filluar edhe disa shtete të rajonit. Serbia më herët ka paralajmëruar se është e gatshme për dozën e tretë, kurse nga e hëna, më 27 shtator, edhe qytetarët mbi moshën 65-vjeçare të Maqedonisë së Veriut po marrin dozën përforcuese.

Kjo dozë e vaksinës duhet të aplikohet edhe në Kosovë si në shumë vende të Evropës dhe botës, thotë infektologu Sali Ahmeti. "Ne duhet të përcjellim trendët e vendeve evropiane, pa diskutim, meqenëse kemi të bëjmë me kërcënime të përbashkëta dhe doza e tretë duhet të vijë në shprehje edhe te ne, por personalisht mendoj se prioritet duhet të jetë marrja e dozës së dytë. Ndërsa do të ishte

e preferuar edhe gjetja e mundësive për marrjen e dozës së tretë", ka theksuar infektologu Ahmeti.

Hana Xhemaili, specialiste për hulumtime të politikave globale shëndetësore, ka theksuar se dhënia e dozës së tretë të vaksinës në Kosovë është e nevojshme, por kur të përfundojë vaksinimi kundër koronavirusit edhe në vende të varfra që nuk e kanë marrë as dozën e parë. Megjithatë, ajo shprehet se kur merren parasysh praktika e vendeve të rajonit, edhe Kosova duhet të diskutojë për këtë çështje. "Kur e shohim rajonin, Kosova procesin e vaksinimit e ka nisur më vonë se të tjerët. Vaksinimi ka filluar në muajin mars me doza të pakta, ndërkaq deri më

tani janë vaksinuar mbi 500 000 persona me dozën e dytë. Kështu që ne duhet të presim nga 6-9 muaj për të marrë dozën e tretë. Në këtë aspekt nuk jemi vonë, por nuk është herët që të diskutohet për mundësinë e dhënies së dozës përforcuese", ka thënë Xhemaili.

Shtetet të cilat kanë filluar dhënien e dozës së tretë të vaksinës e kanë filluar më herët fushatën e vaksinimit dhe doza e tretë është duke iu administruar kategorive të caktuara të shoqërisë, siç janë të moshuarit, personat me sëmundje kronike, ata që janë në qendrat e kujdesit për të moshuar, punëtorët shëndetësorë dhe një kategori e fëmijëve me imunitet të komprometuar.



por qëllimet e tyre janë thellësisht politike dhe në dëm të sovranitetit të vendit tonë", ka deklaruar Sveçla. Ai ka thënë se ka mirëpritur ndihmën e misionit të KFOR-it dhe të EULEX-it për situatën në veri. "Situata atje është e qetë dhe e kontrolluar me ndihmën e shteteve aleate dhe me ndihmën e misioneve aleate. Paqësisht do ta tejkalojmë këtë situatë", ka thënë Sveçla.

Forcat paqeruajtëse të NATO-s kanë njoftuar të hënë se kanë shtuar patrullimet gjithandej Kosovës përfshirë edhe veriun. "KFOR-i ka marrë hapa të mëtejshëm në terren, duke shtuar patrullimet përgjatë rrugëve kryesore të prekura nga bllokimet dhe duke vendosur njësitë e tij edhe në vendkalimet kufitare në Jarinjë e Bërnjak, në përputhje me mandatin e tij, që buron nga Rezoluta 1244 e

Këshillit të Sigurimit të OKB-së e vitit 1999. KFOR-i, gjithashtu, ka zhvilluar bisedime me të gjitha palët e përfshira për ndërprerjen e protestave në veri të Kosovës. Masat që janë diskutuar më herët nga komandanti i KFOR-it me të gjitha institucionet e Kosovës dhe me kryetarët e komunave veriore kanë për qëllim ndihmesën për uljen e shpejtë të tensioneve të krijuara javën e fundit dhe rikthimin e

një mjedisi të sigurt dhe lirisë së lëvizjes për të gjitha komunitetet në Kosovë", është thënë në komunikatën për media të KFOR-it.

Rrugët në Jarinjë dhe Bërnjak janë bllokuar që prej 20 shtatorit, kur Kosova ka vendosur masën e reciprocitetit për targa të automjeteve që vijnë nga Serbia. Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës, të gjitha automjetet me targa të Serbisë që qarkullojnë

në Kosovë duhet t'i heqin ato dhe të vendosin targa të përkohshme. Pas këtij vendimi të qeverisë, serbët lokalë kanë vendosur kamionë dhe mjete të tjera në rrugë. Ndërkaq, më 25 shtator kanë ndodhur dy incidente në veri të Kosovës. Në Zubin Potok është djegur Qendra për Regjistrimin e Automjeteve, ndërkaq në Zveçan është sulmuar Qendra e Regjistrimit Civil.

Koncept-dokumenti për vetingun dërgohet në qeveri

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, së bashku me zëvendësministren Nita Shala, kanë mbajtur të martën një konferencë për media në të cilën kanë njoftuar opinionin publik për zhvillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë. Sipas ministres Haxhiu, marrë parasysh faktin se sistemi i drejtësisë në Kosovë ballafaqohet me sfida dhe probleme të shumta, shkaktarë të të cilave vlerësohet të jetë integriteti i mangët i disa pjesëtarëve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, profesionalizmi në nivelin e dëshiruar dhe ndikimet nga jashtë, është parë si i domosdoshëm që të zhvillohet procesi i vetingut në institucionet e sistemit të drejtësisë. “Verifikimi i integritetit personal të subjekteve të vetingut, vlerësimit profesional dhe të performancës si dhe kontrollit të pasurisë së tyre janë shtyllat kryesore mbi të cilat është zhvilluar dhe kompletuar ky dokument dhe mbi të cilat do të zhvillohet vetingu. Është punuar me kujdesin më të madh që mbi bazën e këtyre shtyllave të garantohej një proces i drejtë dhe profesional, i pavarur dhe efektiv”, ka thënë ministrja Haxhiu.

Ajo ka bërë me dije se në koncept-dokument janë përfshirë praktikatat e ndryshme

ndërkombëtare të cilat kanë kaluar nëpër procesin e vetingut si dhe është bërë një analizë e thellë për nevojat dhe mënyrat se si të zhvillohet ky proces. “Institucionet e drejtësisë do të jenë institucione që i shërbejnë drejtësisë, jo individëve e grupeve”, ka theksuar ministrja Haxhiu. Ajo ka thënë se mbetën të vendosur që këtë reformë të rëndësishme të sundimit të ligjit ta avancojnë tutje, në mënyrë që në institucionet e drejtësisë të kenë integritet dhe profesionalizëm duke kthyer kështu besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Nga ana tjetër, zëvendësministria Shala ka paraqitur rekomandimet e paraqitura nga grupi punues i cili ka identifikuar dhe analizuar në detaje pesë opsione që potencialisht mund të ndiqen. Sipas rekomandimeve, opsioni i parë ka të bëjë me ruajtjen e status quo-s, opsioni i dytë adreson përmirësimin e zbatimit të kornizës ekzistuese ligjore, opsioni i tretë parasheh zhvillimin e vetingut përmes ndryshimeve ligjore, opsioni i katërt parasheh zhvillimin e vetingut përmes ndryshimeve kushtetuese duke krijuar mekanizma të jashtëm të përhershëm vetingu dhe opsioni i pestë është opsion i kombinuar mes ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore dhe parasheh zhvillimin e procesit të vetingut duke krijuar mekanizma të jashtëm vetingu dhe duke ndërtuar mekanizma të rinj në kuadër të Këshillit Gjyqësor dhe



atij Prokurorial të Kosovës për të vijuar vlerësimin e përhershëm të gjyqtarëve e prokurorëve. Zëvendësministria Shala ka thënë se ky koncept-dokument vendos bazat kryesore se si duhet të zhvillohet procesi i vetingut në sistemin e drejtësisë, me ç'rast gjatë punimit të

amendamenteve kushtetuese dhe ndryshimeve të nevojshme ligjore do të adresohen të gjitha çështjet të cilat do t'i kontribuojnë një verifikimi profesional, të paanshëm dhe me integritet.

Haxhiu dhe Shala gjatë kësaj konference kanë vlerësuar lart

angazhimin dhe profesionalizmin e anëtarëve të grupit punues të cilët kanë finalizuar një nga koncept-dokumentet më të rëndësishëm për sistemin e drejtësisë i cili tashmë është proceduar për qeveri dhe pritet të votohet në mbledhjen e saj të radhës.

Kurti nënshkruan memorandum mirëkuptimi për projektet arsimore



PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Në një ceremoni të organizuar në qeveri, kryeministri i Albin Kurti ka nënshkruar të martën memorandum mirëkuptimi me Kerstin Zielosko, kryetare e Education Unlimited e.V. Me qëllim të thellimit të bashkëpunimit ekzistues, përmes këtij memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe

Education Unlimited e. V., u vendosën parimet kryesore për vazhdim të bashkëpunimit mbi projektin arsimor ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë. Të dyja palët u pajtuan që të kryejnë projekte të përbashkëta në fushën e arsimit, duke mos u kufizuar në programe të shkëmbimit për studentë dhe nxënës, projekte kërkimore,

programe edukimi dhe trajnime, konferenca arsimore dhe kulturore, për një periudhë pesëvjeçare, me mundësi vazhdimi. Në ceremoninë e nënshkrimit të memorandumit ishin edhe ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arberie Nagavci, koordinatoreja e projektit, Milote Sadiku dhe udhëheqësi i projektit, Luan Krasniqi.

Nis fushata sensibilizuese për punësim në Policinë e Kosovës

FERIZAJ, 28 SHTATOR (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj të martën ka nisur fushatën sensibilizuese për aplikim për punësim në Policinë e Kosovës. Policia, në prani të mediave lokale, ka shpërndarë fletushka sensibilizuese për procedurat e aplikimit për punësim në Policinë e Kosovës, ku janë dhënë informata të nevojshme për procesin e

aplikimit, i cili do të nisë së shpejti. Kushtet për aplikim janë: të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, të jetë i moshës 18-30 vjeçar, ta ketë të përfunduar shkollimin e mesëm, të jetë në gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale, të mos jetë i dënues për ndonjë vepër penale, të mos ketë në vend të dukshëm tatuazh (fytyrë, qafë, duar) dhe të ketë

integritet personal dhe vlera të larta etike. “Qëllimi i kësaj fushate ishte sensibilizimi i qytetarëve, me synim që gjeneratat e reja të dygjinive, të të gjitha komuniteteve, të aplikojnë për punësim në polici dhe t’u shërbejnë qytetarëve të tyre”, ka njoftuar policia. Kësaj, për disa ditë do të shpërndahen fletushka edhe në komunat e tjera.



Blokada ul importin e mallrave nga Serbia



PRISHTINË, 28 SHTATOR - Bllokimi i dy pikave kufitare Jarinjë dhe Bërnjak, që lidhin Kosovën me Serbinë, ka çuar në ulje të numrit të mallrave të importuara nga Serbia në Kosovë. Dy vendkalimet kufitare janë të bllokuara nga serbët

lokalë qysh më 20 mars për shkak të masës së reciprocitetit që ka vënë Qeveria e Kosovës ndaj automjeteve me targa të Serbisë. Dogana e Kosovës ka bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë" se gjatë periudhës 20-24 shtator

nga Serbia janë importuar mallra në vlerë prej 3.9 milionë eurosh. Ndërsa pesë ditë para vendosjes së masës së reciprocitetit, përkatësisht nga 15 deri më 19 shtator, janë importuar mallra në vlerë prej 4.9 milionë eurosh. Me vendimin e Qeverisë së

Kosovës, të datës 20 shtator, të gjitha automjetet me targa serbe, që hyjnë në Kosovë, duhet t'i heqin targat dhe të vendosin targa të përkohshme të lëshuara nga autoritetet e Kosovës. Një masë të ngjashme për automjetet me targa të Kosovës,

Serbia e zbaton tash e sa vite. Përfaqësuesit e Serbisë e akuzojnë Kosovën për shkeljen e dispozitave të Marrëveshjes së Brukselit për lëvizje të lirë, por përfaqësuesit e Kosovës thonë se po veprojnë në përputhje me marrëveshjen.

Arbitrazhi rrezikon buxhetin e Shqipërisë

TIRANË, 28 SHTATOR - Gjyqet që shteti shqiptar ka humbur në Arbitrazhin Ndërkombëtar do të rëndojnë edhe më tej financat e qeverisë, madje në paraqitjen e buxhetit faktit pranohet se vendimet e arbitrazhit vlerësohen me risk të konsiderueshëm për buxhetin e shtetit. Në dokumentin e paraqitur në Kuvend thuhet se ato kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë për zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy ose shumëpalëshe në ngarkim të shtetit shqiptar. Vlera e arbitrazhit e paguar nga

buxheti i shtetit shqiptar për vitin 2020 arriti 33.3 milionë lekë dhe të gjitha vendimet janë përballuar nga buxheti i ministrive të linjës të cilat kanë qenë palë të paditura. Nga këto, 1.5 milion lekë janë paguar nga Ministria e Infrastrukturës për likuidimin e faturave të shërbimeve juridike për mbrojtjen në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar. 8 694 milionë lekë nga Ministria e Bujqësisë për pagesën e kostove administrative të tribunalit dhe vlera më e lartë prej 23.1 milionë lekësh është paguar nga Ministria e Financave për



pagesën e shërbimeve juridike dhe procesin e anulimit të një

vendimi arbitrazhi. Por vetëm së fundi qeveria

shqiptare detyrohet të paguajë plot 110 milionë euro për afaristin italian Francesco Becheti pasi mbyllja e televizionit "Agon Channel" u konsiderua e padrejtë. Vetë kreu i qeverisë shqiptare, Edi Rama, ka përsëritur disa herë se fjala e fundit për çështjen "Becheti" nuk është thënë ende dhe se sipërmarrësi italian nuk do të marrë asgjë nga Shqipëria, por tashmë detyrimi është kthyer në fakt. Një tjetër shumë prej 44 milionë dollarësh është humbur përballë kompanisë që do të ndërtonte autostradën Tiranë - Elbasan.

Valon Tolaj dorëhiqet nga pozita e drejtorit menaxhues të AKP-së



PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Drejtori menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Valon Tolaj, ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë. Ai në një shkrim të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë me dije se

për dorëheqjen e tij zyrtarisht e ka njoftuar bordin e drejtorëve me vendimin e tij. "Falënderoj kolegët për bashkëpunim për tre vjet me radhë. Ish-anëtarëve të bordit të drejtorëve u jam mirënjohës për mbështetjen, po

ashtu bordit të drejtorëve aktualë për qasjen dhe korrektësinë. Drejtimi që po merr procesi i transformimit të pronës shoqërore dhe koha e mbetur e mandatit tim më kanë bërë të vlerësoj se kontributi im i

mëttutjeshëm në AKP është i panevojshëm edhe më tutje", ka shkruar Tolaj, i cili ishte emëruar në pozitën drejtor menaxhues me mandat prej katër vjetësh në nëntor të vitit 2018, pas shkarkimit të Ekrem Hajdarit.

Zgjatet deri më 5 tetor afati për aplikim për subvencione

PRISHTINË, 27 SHTATOR (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka njoftuar të gjithë fermerët se afati për

aplikim për pagesa direkte - subvencione për vitin 2021 është zgjatuar deri më 5 tetor. Kjo zgjatje e periudhës për aplikim po

bëhet për shkak të kërkesave të fermerëve dhe drejtorive komunale për bujqësi duke iu mundësuar në këtë

mënyrë aplikimin të gjithë fermerëve që kanë mbetur pa aplikuar deri më tani në kuadër të Programit për Pagesa Direkte 2021.



KUMTESË E KONFERENCËS SHKENCORE E ORGANIZUAR NGA INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" NË PRISHTINË / "DEMONSTRATAT E VITIT 1981 NË KOSOVË DHE VENDIMET POLITIKE TË BEOGRADIT SIPAS DOKUMENTEVE ARKIVORE NË ARKIVIN E KOSOVËS" (7)

Aktivitetet politike të ilegales pas demonstratave

Prof. ma. Adem ADEMI

Çdo qytetar i Kosovës i cili ka përjetuar ndërhyrjen agresive të forcave policore-ushtarake jugosllave ndaj studentëve dhe qytetarëve shqiptarë në ditët e demonstratave më 1, 2 dhe 3 prill në qytetet e Prishtinës, Podujevës, Ferizajt dhe në Vushtrri, nuk ka mundur të besojë se do të ketë më organizim të aktivitetit politik propagandistik e aq më pak ka mundur të marrë me mend se do të ketë përpjekje apo organizim për demonstratë të tjera në Kosovë.

Pas ndërprerjes së dhunshme të demonstratave masive, shteti totalitar në fazën tjetër zbaton ofensivën politike për realizimin e masave politike të përgatitura nga kuzhina politike e Beogradit. Ofensiva shtohet për çdo ditë ndaj shqiptarëve dhe realizohet në tri fronte. Në "Luftimin e aktiviteve të mëtejshme të irredentës: diferencimin ideopolitik: ndërmarrjen e masave konkrete e represive ndaj të gjithë organizatorëve të demonstratave dhe bartësve të aktiviteve ilegale". Ofensiva politike shtetit kishte statistikën e saj. Në Kryesi u konstatua se organet e punëve të brendshme me qëllim të zhdukjes së aktivitetit armiqësor dhe të pengojnë përhapjen e mëtejme të aksioneve armiqësore me rastin e demonstratave prej 11 marsi deri më 10 prill kanë marrë një varg masash parambrojtëse për 1 500 veta.

Pas 3 prillit 1981, kundër ofensiva e ilegales shqiptare me aksionet e saj politike shtrihet anembanë trojeve shqiptare me aktivitete politike dhe propagandistike në shpërndarjen e parullave, afisheve, në bartjen e simboleve kombëtare, në organizimin të demonstratave me përmasa të ndryshme. "Ata vazhduan aktivitetin e tyre politik dhe propagandistik nëpër qytete dhe vendbanime të ndryshme.

Numri i shkrimeve të parullave nëpër komuna për nga numri ishte i ndryshëm, ato dallonin nga vendi në një vend tjetër. "Në rrethinën e Podujevës në natën 1-2-8 janë gjetur 16 shpallje armiqësore, parulla dhe pamflete. Në Ferizaj janë gjetur 24 pamflete. Po ashtu në Suharekë, Deçan, Gjilan e tjera komuna. Parullat janë shkruar nëpër mure të oborreve, nëpër mure të shtëpive, nëpër dyer të oborreve, në muret e shkollave, muret e fabrikave dhe nëpër rrugët nacionale e në tjera objekte.

Materialet propagandistike kishin edhe nënshkrimet e grupeve ilegale shqiptare që vepronin dhe shpërndanin materialet si: në Podujevë "Shoqëria llapjane e hakmarrjes", "Komiteti i malësorëve për çlirim të Kosovës", "Zëri i atdheut" në Ferizaj e tjera grupe ilegale nëpër komuna.

Përmbajtja e parullave të shkruar më së shumti kishin përmbajtjet si: "Kosova Republikë", "Rroftë Republika e Kosovës", "Republikë ose vdekje", "Rroftë rinia studentore", nuk pajtohemi pa republikë,

të gjithë do ta japim jetën, nuk do ta harrojmë padrejtësinë që ju ka bërë popullit shqiptar, për ty Kosovë kemi derdhur shumë gjak dhe deri në vdekje do derdhim gjak dhe nuk duam të jetojmë me ju, do ta mbrojmë edhe me armë të tjera, kriminel mos i dënoni njerëzit e pafajshëm, kërkojmë të drejtat tona, e të tjera. Ilegalja dërgoi në adresë të komunave programin dhe qëllimet politike të tyre. "Në adresë të Kuvendit Komunal të Ferizajt, Dragashit, dhe Vitisë ka arritur pamfleti me përmbajtje armiqësore me nënshkrim të Partisë Marksiste Leniniste të shqiptarëve të Jugosllavisë. Në pamflet sqarohet programi dhe qëllimi i "kësaj" partie.

Ky realitet i aksioneve të ilegales në terren raportohet në mbledhjet e KK të Kosovës. "Së pari, menjëherë duhet të them se gjatë gjithë kësaj periudhe pas ngjarjeve kundër evolucionare, shërbimi është përballur me aktivitetin armikut nga pozicionet e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar. Në kryesi u vu në dukje domosdoshmëria e zhvillimit të mëtejshëm të aksionit kundër veprimit të armikut, në zbulimin e organizatorëve të tij. Gjatë muajit prill dhe maj, kur po zbatohet ora policore, gjendja e jashtëzakonshme nga rinia shqiptare u organizuan demonstrata në disa qytete si në: Prishtinë, Istog dhe Kaçanik, tentuan të organizojnë demonstratë në Malishevë, Gjilan, Suharekë, Lipjan, Rahovec, Viti, e Deçan. Rinia studentore ishte shumë



aktive nëpër qytete të Kosovës në bartjen e simboleve kombëtare, sidomos rina prishtinase gjatë shetitjes së lirë në korzë. Rinia e shkollave të mesme, medresistët dhe studentët e Prishtinës dilnin në korzë për shetitje duke bartur plisin e bardh, shallin kuq e zi, fanella sportive kuq e zi e simbole tjera kombëtare.

Pushteti i dhunshëm herë pas here publikonte statistikën e burgosjes së rinisë kosovare duke e vlerësuar si sukses të madh punën e organeve të brendshme. Statistikat e publikuara për numrin e shqiptarëve të burgosur dhe të dënuarve me dënime drakonike kishin për qëllim të shtonin presionin psikik te rinia dhe lëvizja për republikën e Kosovës që të hiqnin dorë nga aktiviteti politik propagandistik dhe nga kërkesat e tyre politike. Burgosjet e shumta të anëtarëve të lëvizjes për republikën e Kosovës, shpeshherë rrezikonte shuarjen e një grupi apo organizate ilegale.

Por, menjëherë organizoheshin grupe të tjera nëpër vende të tjera. Lëvizja vazhdonte të shtrihet dhe vepronte me aktivitetin e saj politik propagandistik. Shërbimi ka zbuluar shumë grupe dhe mbi 100 persona të cilët kanë shkruar parulla armiqësore, aksione armiqësore të shkrimeve të parullave dhe shpërndarjen e afisheve me përmbajtje armiqësore nga pozicioni i nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar është në rritje.


Dokumentet nga proceset gjyqësore tregojnë se shumica prej tyre nuk janë penduar fare për veprimet e tyre politike dhe janë shprehur në prani të gjykatës dhe të pranishmëve se Kosova duhet ta ketë dhe meriton statusin e Republikës. Ata ishin prezent dhe shumë aktiv në proceset e mëvonshme politike deri në çlirimin e Kosovës.

(Vijon. Fusnotat i ka hequr redaksia)



Emil Zola, tragjedia që mbeti enigmë

Shkrimtari më i famshëm francez i kohës së tij, vdiq në moshën 62-vjeçare, më 29 shtator 1902, në rrethana tejet të çuditshme.



Emil Zola dhe e shoqja, Aleksandrina, u kthyen në shtëpinë e tyre në "Rue de Bruxelles" në Paris më 28 shtator, si me magji. Ishte kohë e ftohtë dhe e lagësht, si për çudi në dhomën e tyre të gjumit ndezën zjarr qymyri pa tym për natën. Fjetën me dritare mbyllur, kurse Zola e mbylli derën, siç bënte gjithmonë. Vitet e fundit kishte marrë shumë kërcënime për jetën. Pa e kuptuar se çfarë po ndodhte, dalëngadalë që të dy u asfiksuan nga tymi i monoksidit të karbonit. Rreth orës tre të mëngjesit u zgjuan dhe ndiheshin keq, por Zola e ndaloi Aleksandrinë të ngrinte shërbëtorët për atë që ai mendonte se ishte thjesht një krizë mostretjeje.

Qe një vendim fatal, pasi, më vonë, kur ai u ngrit nga shtrati, ndoshta për të hapur dritaren, dhe ra në dysheme, ajo nuk lëvizte dot nga vendi. Në orën 9:00 të mëngjesit, të shqetësuar se diçka nuk shkonte, shkallmuan derën e dhomës së gjumit. Zola ishte në dysheme, i vdekur ose gati i vdekur. Aleksandrina dergjete në shtratin e saj, pa ndjenja. Erdhën mjekët dhe i dhanë Zolasë ndihmën e parë, frymëmarrje artificiale për 20 minuta ose më shumë, por më kot. Aleksandrina u dërgua në klinikë. Gjatë pasdites, ajo i kishte çuar fjalë të dashurës së të shoqit, Zhanë Rozero dhe dy fëmijëve të saj me të, Denisa dhe Zhaku. Denisa sapo kishte mbushur të 13-at dhe

Zhakun të 11-at. Zhana e tmerruar doli menjëherë në përfundimin se Zola ishte vdekur.

Zhanë Rozero ishte 27 vjet më e re se Zola dhe kishte qenë dashnorja e tij prej vitit 1888, një situatë që Aleksandrinë e kishte pranuar me gjysmë zemre, pasi ajo dhe Zola, nuk kishin fëmijë.

Metresa nuk do të ishte personi i vetëm që dyshonte për diçka të dyshimtë, në lidhje me vdekjen e shkrimtarit. Ai kishte bërë armiq fanatikë në të djathtën nacionaliste, nisur nga sulmi ndaj autoriteteve mbi çështjen "Dreyfus". Ndërkohë, trupi i tij dergjete në një arkivol të hapur zbkuruar me lule në shtëpinë e Parisit. Mes atyre që erdhën t'i bëjnë nderimet ishte edhe Alfred Dreyfusi, po ashtu Zhana dhe dy fëmijët shkelnin për herë të parë në shtëpi. Aleksandrina u kthye nga klinika dhe, më 5 tetor, një të diel, një turmë prej rreth 50 000 shoqëroi kortezhin në Varrezat Montmartre, ku morën pjesë ministra të qeverisë, zyrtarë dhe delegacione të minatorëve dhe masonëve. /Konica.al/Ushtarët nderuan me armë ndërsa kalonte makina e funeralit. Ishte i pranishëm edhe Dreyfus dhe Anatole France, i cili mbajti një fjalim plot lavde për Zolanë.

"Zola, është i denjë për vendin e tij, sepse nuk e humbi besimin në aftësinë për të sunduar me ligj" – duke përfunduar: "Ai ishte një

moment në historinë e ndërgjegjes njerëzore".

U përhapën thashetheme, se Zola ishte vdekur.

U urdhërua një hetim, specialistët kryen teste në shtëpinë e Parisit, u ndez zjarri, por pati fare pak shenja të monoksid karbonit, madje derrat që u mbyllën në dhomë nuk pësuan asnjë dëmtim. U çmontua oxhaku, por asgjë me rëndësi nuk u


gjet, megjithëse sasia e blozës së oxhakut nuk ishte fshirë siç duhet. Mjeku ligjor, me sa duket i shqetësuar për të zbutur situatën, nuk pranoi të bënte publike raportet e ekspertëve dhe njoftoi se vdekja e Zolasë kishte ardhur për shkaqe natyrore.

Vite më vonë, në 1953, një letër drejtuar një gazete franceze, pohonte se Zola ishte vdekur nga një anti-Dreyfusard, kontraktues montimi oxhakësh, ndërsa po

riparohej çatia e shtëpisë ngjitur. Ai dhe njerëzit e tij e kishin bllokuar me qëllim oxhakun e shtëpisë së Zolasë pa u vënë re, në hyrjen dhe daljen e përgjithshme, po ashtu e kishin zhblokuar atë në heshtje herët të nesërmen, përsëri pa u vënë re. Me sa duket, atë që kishte bërë e rrefeu në shtratin e vdekjes në vitin 1927. Disa nga biografët e Zolasë e kanë pranuar rrëfimin, por Frederick Brown, në biografinë e tij magjistrale, del në përfundimin se historia mund të ketë qenë e vërtetë, por e ka të pamundur të jetë i sigurt.

Në vitin 1908, trupi i Zolasë u zhvendos në Panteon, mauzoleun e nderuar të të mëdhenjve të Francës.

Pati përplasje dhe goditje, ndërsa nacionalistët e zemëruar u përpoqën të ndalonin makinën, por u ndaluan nga policia dhe ushtarët, kurse arkivoli u vendos në një katafalk të lartë. Në ceremoninë e rivarrimit mori pjesë edhe Presidenti. Aleksandrina, Zhana dhe dy fëmijët ishin të pranishëm. Po ashtu ishte i pashmangshëm edhe Dreyfus, i cili, u qëlluan me dy të shtëna pistolette nga një burrë pranë katafalkut, një gazetar i quajtur Louis Gregori. Dreyfus mori një plagë të lehtë në krah. Pasi mbaroi gjithë trazira, Aleksandrina, Zhana dhe fëmijët zbritën në dhomën e nëndheshme, ku Emil Zola u varros pranë një tjetër titani, Viktor Hygosë. / KultPlus.com



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Përurohët Qendra Nacionale e Xhudos në Pejë

Qendra Nacionale e Xhudos në Pejë është përuarur të martën. Të pranishëm ishin drejtues të institucioneve qendrore dhe lokale, drejtues të parive opozitare, sportistë dhe sportiste të shumta. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se Qendra Nacionale e Xhudos do të bëhet shtëpi edhe për shumë kampionë të tjerë olimpikë. Ndërsa trajneri Driton Kuka dhe sportistet olimpike Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova janë shprehur të lumtura, pasi tash do të kenë mundësinë të përgatiten në kushte më të mira



thënë Çeku. Ndërsa trajneri i Xhudos, Driton Kuka, krahas përuimit të qendrës, vlerësoi lart praninë e të gjithë atyre që e përkrahën këtë projekt. “Është një moment i rëndësishëm. Është mirë që të gjithë protagonistët, njerëzit që e kanë përkrahur ndërtimin e qendresë, ishin këtu të pranishëm përfshirë qeverinë, kryetarin e Federatës Botërore të Xhudos, komunën e Pejës, Komitetin Olimpik të Kosovës, Federatën e Xhudos së Kosovës etj. Është shumë e rëndësishme që gjatë stërvitjeve secili garues të ketë trajnerin afër vetes dhe hapësirën e duhur, në aspektin teknik e sidomos në aspektin tatam për të cilin sportistët kanë nevojë dhe ky ka qenë problemi më i madh për mua si trajner”, ka deklaruar Kuka.

Të lumtura për ndërtimin e Qendrës së re janë shfaqur edhe tri kampionet olimpike, Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova.

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PEJË, 28 QERSHOR - Qendra Nacionale e Xhudos është përuarur të martën në lagjen “Asllan Qeshme” në qytetin e Pejës. Të pranishëm në ceremoninë e përuimit ishin presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, kryeministri Albin Kurti, kryetari i Federatës Ndërkombëtare të Xhudos, Marius Vizer, ministri i Kulturës,

dhe Nora. Jeni ju që na bëni të mburremi me sukseset tuaja. Fillimet tuaja sigurisht se nuk kanë qenë të lehta. Puna dhe stërvitja e madhe dhe përkushtimi që keni pasur ka sjellë suksesin e madh. Ju e zbardhët fytyrën e një kombi të tërë”, ka thënë presidentja Osmani.

Ndërsa kryeministri Albin Kurti në fjalën e rastit ka thënë se ekipi i xhudos është shembulli më i mirë edhe për fushat e tjera, pasi

mundur pa suksesin tuaj të deritanishëm. Kjo qendër do të ndihet e zbrazët pa ju. Kjo qendër është sepse ju jeni në qendër”, ka thënë Kurti.

“Ekipi i xhudos është shembull për të gjitha fushat e tjera, pasi kur ka punë, sukcesi nuk qëndron larg, pavarësisht se nga vjen ai. Jam i nderuar e i lumtur që sot po i hapim dyert e kësaj ndërtese e cila është realizuar me Federatën e Xhudos Botërore dhe Federatën e Xhudos së Kosovës. Bashkërisht u kemi ndërtuar shtëpi kampionëve olimpikë dhe kampionëve të ardhshëm. Sporti është prioritet shtetëror. Qëllimi ynë është të rritim sportin e xhudos, e në lojërat e ardhshme olimpike të fitojmë medalje të tjera. Kjo do të jetë më e lehtë për të gjithë, veçanërisht për Dritonin, pasi tash Majlinda do të jetë pjesë e ekipit të tij të trajnerëve. Është kënaqësi e jashtëzakonshme kur një kampione olimpike si Majlinda e vazhdon rrugëtimin në sport edhe pas përfundimit të karrierës së saj aktive. Është edhe më madhështore kur një qendër do të ketë në krye të trajnerëve Majlinda Kelmendin. Nuk kam dyshim se ky vend do të bëhet shtëpi edhe për shumë kampionë të tjerë olimpikë”, ka deklaruar Kurti.

I pranishëm në ceremoninë e përuimit ishte edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, i cili është shprehur i lumtur se sportistët që e bënë krenar një komb të tërë, tash do ta kenë shtëpinë e tyre. “Sportistët që i kanë dhënë shpresë, krenari dhe emocion një kombi të tërë, që me sukseset e tyre kanë kaluar çdo parashikim, Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi, Nora Gjakova dhe xhudistët e tjerë, së bashku me trajnerin e tyre, Driton Kuka, tashmë do të kenë shtëpinë e

tyre të xhudos. Sot në qytetin e Pejës, në një ambient shumë të veçantë, të rrethuar me malet e bukura të Rugovës, përuam Qendrën Nacionale të Xhudos. Jam shumë i lumtur që tash gjenerata të tëra talentësh të rinj në sportin e xhudos do ta kenë një vend të denjë për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve sportive, të dedikuar pikërisht për ta”, ka

Kurti: Majlinda Kelmendi do të shpallet ‘Qytetare me merita të veçanta’.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije të martën në Pejë se në mbledhjen e radhës të Qeverisë së Kosovës, Majlinda Kelmendi do të shpallet “Qytetare me merita të veçanta”. “Ju njoftoj se në mbledhjen e radhës të Qeverisë së Kosovës, Ministria e Sportit do të propozojë vendimin për

shpalljen e Majlindës person me merita të veçanta, për atë që i ka sjellë vendit tonë. Kjo është më e pakta që mund të bëjmë për të personalisht”, ka thënë Kurti, i cili ka bërë me dije se të mërkurën do të nënshkruhet edhe vendimi për shërbimin e kampioneve olimpike, Distria Krasniqi, Nora Gjakova dhe trajnerit Driton Kuka.



Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, kryetari i komunës së Pejës, Gazmend Muhaxhiri, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, përfaqësuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës dhe të Federatës së Xhudos së Kosovës dhe shumë personalitete të tjera vendore dhe ndërkombëtare. Presidentja Osmani nderoi me medaljen “Nderi i Republikës” Distrian dhe Norën, ndërsa Distrias edhe me medaljen “Presidenciale e Meritave”, të cilën më herët e kishte pranuar Nora dhe Majlinda. Po ashtu, është dekoruar edhe trajneri Driton Kuka me “Medaljen Presidenciale”. “Xhudistët tanë sot janë bërë me një shtëpi ashtu siç e meritojnë. Historia gjithmonë do të flasë për ju. Së pari Majlinda e më pas Distria

kur ka punë sukcesi nuk qëndron larg. Kryeministri i vendit ka shprehur optimizëm se Qendra Nacionale e Xhudos në Pejë do të bëhet shtëpi edhe për shumë kampionë të tjerë olimpikë. “Kam kënaqësinë që jam këtu për të shënuar një fillim të ri të sportit të xhudos në Kosovë. Për dallim nga herët e kaluara, kur kryefjalë ishte sukcesi i sportistëve tanë, këtë herë po shënojmë ndërtimin e Qendrës Nacionale të Xhudos në Kosovë. Këtu, në këtë vend të rrethuar me malet e Rugovës, në lagjen të Pejës, Kosova prodhoi katër kampionë olimpikë, tri sportiste dhe një trajner: Majlindën, Norën, Distrian dhe Dritonin. Duke ju falënderuar ju të dashura kampione, malet e Rugovës janë shndërruar në olimpin tonë sportiv. Kjo qendër nuk do të ishte as e njëjtë e as e



Trajneri i Suedisë: Kosova është e aftë të na krijojë probleme

STOKHOLM, 28 SHTATOR - Kombëtarja e Suedisë e ka publikuar listën e lojtarëve për ndeshjet e muajit tetor, të vlefshme për eliminatorët për Kupën e Botës. Pjesë e kësaj liste do të jetë edhe sulmuesi i Milanit, Zlatan Ibrahimović. Suedia përballet

me Kosovën më 9 tetor, ndërsa tri ditë më vonë takohet me Greqinë. Trajneri i Suedisë, Janne Andersson, ka thënë se Kosova është ekip individualisht i aftë që do të provojë t'u krijojë probleme. "Së pari, ne duhet të jemi sa më mirë të

përgatitur për Kosovën. Ne e dimë se është një ekip individualisht i aftë që do të bëjë gjithçka për të na krijuar probleme. Kosova, ndër të tjera, bëri një lojë shumë të mirë kundër Spanjës herën e kaluar", ka thënë Andersson.



Hoxha: Radhën e ka Llapi

Yll Hoxha për "Epokën e re" ka thënë se, pas fitores kundër Dritës, Gjilani pret tri pikë të plota edhe kundër Llapit. "Ndeshja e radhës për ne është mjaft e vështirë, pasi Llapi ka një skuadër tepër kualitative, por ka mungesë të rezultateve në ndeshjet e para. Ne e vlerësojmë maksimalisht kundërshtarin, por do t'i hyjmë kësaj ndeshjeje me besimin më të madh për fitore", ka thënë Hoxha

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Skuadra e Gjilanit ka shënuar fitore shumë të rëndësishme në derbin ndaj Dritës (0-2). Futbollisti që gjatë verës e përforcoi skuadrën e Gjilanit, Yll Hoxha, ka thënë të martën për "Epokën e re" se tri pikët e marra në derbin e fundjavës janë shumë të rëndësishme për faktin se rivaliteti mes dy klubeve është mjaft i madh. "Për ne ishte një ndeshje e rëndësishme duke pasur parasysh rivalitetin ndër vite dhe normalisht pikët ishin të rëndësishme. Realisht ne besojmë në potencialin që kemi dhe në secilën ndeshje luajmë për

fitore", ka deklaruar Hoxha.

Gjilani me tri pikët e reja është ngritur paksa në renditjen tabelore, por sot (e mërkurë) e pret një tjetër ndeshje e fortë, pasi do të përballet me Llapin. Hoxha ka thënë se, pavarësisht formës që po kalon

BKT Superliga

Të mërkurën takohen:
15:00 Drenica - Malisheva
15:00 Ballkani - Feronikeli
15:00 Gjilani - Llapi

Të enjten takohen:
15:00 Dukagjini - Drita
15:00 Prishtina - Ulpiana



klubi, i cili drejtohet nga trajneri Tahir Batatina, kualiteti nuk i mungon. "Ndeshja e radhës për ne është mjaft e vështirë, pasi Llapi ka një skuadër tepër kualitative, por që ka mungesë të rezultateve në ndeshjet e para. Ne e vlerësojmë


maksimalisht kundërshtarin, por do t'i hyjmë kësaj ndeshjeje me besimin më të madh për fitore", ka thënë Hoxha, i cili me shumë sukses për vite me radhë ka djersitur fanellën e Feronikelit. Mbrotjtësi i majtë ka qenë pjesë

edhe e Prishtinës, Hysit, TPS-së, Kukësit, Flamurtarit dhe Vllaznisë së Shkodrës.

Sot zhvillohen tri ndeshje në Superligë

Në kuadër të javës së shtatë në BKT Superligë, sot (e mërkurë) zhvillohen tri ndeshje shumë interesante. Gjilani, që në fundjavë mposhti skuadrën e Dritës, në këtë ndeshje kërkon tri pikët e reja për t'u ngritur në renditjen tabelore. Ndërsa në anën tjetër, Llapi do të përpiqet të nxjerrë një rezultat pozitiv pasi që deri tash nuk ka treguar rezultate të pritshme. Ndeshje interesante do të zhvillohet edhe në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj, ku Drenica e pret befasinë e deritanishme në elitë, Malishevën. Të dyja këto skuadra do të luajnë për fitore. Ndeshja tjetër zhvillohet në Suharekë, ku Ballkani pret Feronikelin me synim që t'u rikthehet fitoreve. Dy ndeshjet e tjera të kësaj xhironje zhvillohen të enjten: Dukagjini - Drita dhe Prishtina - Ulpiana.

Juventusi sfidon kampionët e Chelseat



TORINO, 28 SHTATOR (ER) - Kampionia në fuqi e Ligës së Kampionëve, Chelsea, do të kërkojë sonte (e mërkurë) të harrojë humbjen e fundjavës në Premierë Ligë nga Manchester City dhe të marrë rezultat pozitiv ndaj Juventusit në Torino. Në anën tjetër, "Zonja e Vjetër" synim ka fitoren e katërt në pesë ndeshjet e fundit në të gjitha garat. Juventusit pati një start jashtëzakonisht të keq në Serinë A me Massimiliano

Allegri, por tash është rikthyer dhe pozicionohet në vendin e dhjetë me 8 pikë, dhjetë pikë më pak se skuadra kryesuese, Napoli. Në anën tjetër, Chelsea, edhe përkundër humbjes në fundjavë, ka pasur një start të mirë në elitën e futbollit anglez dhe renditet në pozitën e tretë me një pikë më pak se skuadra kryesuese, Liverpool. Juventusit në këtë ndeshje do të jetë pa dyshen Dybala - Morata, kurse Chelsea do

të jetë pa Reece James dhe N'Golo Kante. "Kemi respekt për kualitetin e tyre dhe traditën. Do të jetë një ndeshje e vështirë, por kemi besim në kualitetin tonë. Juve pa Ronaldon? Do ta thotë koha, por çdo ekip pa Ronaldon është më i dobët. Ai ka treguar çdoherë në ndeshjet e Premierë Ligës dhe Ligës së Kampionëve kualitetet e tij. Juventusit ka lojtarë me përvojë, talent, një ekip me shumë kualitet. Do të kemi

GRUPI E		GRUPI G	
21:00 Bayern M. - Dynamo Kyiv 21:00 Benfica - Barcelona		21:00 Salzburg - Lille 21:00 Wolfsburg - Sevilla	
Tabela		Tabela	
1. Bayern M.	3 pikë	1. Salzburg	1 pikë
2. Benfica	1	2. Sevilla	1
3. Dynamo K.	1	3. Lille	1
4. Barcelona	0	4. Wolfsburg	1
GRUPI F		GRUPI H	
18:45 Atalanta - Young Boys 21:00 Manchester United - Villarreal		18:45 Zenit - Malmoe 21:00 Juventus - Chelsea	
Tabela		Tabela	
1. Young Boys	3 pikë	1. Juventus	3 pikë
2. Atalanta	1	2. Chelsea	3
3. Villarreal	1	3. Zenit	0
4. Manchester U.	0	4. Malmoe	0

përballë një skuadër të nivelit tonë. Këto janë ndeshje ku shihet

ekipi më i mirë", ka thënë trajneri i Chelseat, Thomas Tuchel.

Xhaka mungon 6-8 javë

Londër, 28 shtator - Lajm i keq për Arsenalin në lidhje me gjendjen fizike të Granit Xhakës. Pas ekzaminimeve më të hollësishme, është konfirmuar lëndimi i rëndë i mesfushorit shqiptar gjatë një përplasjeje në derbin e

Londrës Veriore përballë Tottenhamit. 29-vjeçari, sipas mjekëve të "Topçinjve", ka pësuar këputje të ligamentit të brendshëm në gjurin e tij të djathtë. Për rrjedhojë, parashikohet një ndalesë prej 6-8

javësh. Kjo do të thotë se Xhaka do të mund të kthehet në fillim të muajit dhjetor, duke humbur shumë ndeshje në Premierë Ligë apo në eliminatorët e Botërorit të muajit tetor dhe nëntor me Zvicrën.



NJOFTIM

Njofetojme te gjithë klientet se Kompania "Villa Argjro" SHPK me seli ne Prizren ka marre vendim te shuaje biznesin me Numri unik identifikues "810049769" dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedures se Likuidimit. Njogtohen te gjitha klientet qe kan raporte Kreditore - Debitorë ne kete shoqeri qe te paraqiten ne afatin 30-ditor nga data e shpalljes ne gazete.

OBAVESTENJE

Obavjestavamo sve klijente da Kompanija "Villa Argjro" DOO sa sedistem u Prizrenu doneo odluku da ugasi biznis po jedinstveni maticni broj "810049769" I ujedno imenovao Livfidatora o sprovođenju postupaka livfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "Villa Argjro" LLC in Prizren has come to the decision to quit its business with Unique Identification Number "810049769". The company has appointed a liquidator who is going to Oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in the company are kindly request to show up with in 30 days starting from the day od newspaper announcement publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Urim Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Dren Qunaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

► Bleona Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Avdyl Frashëri " Prizren.

► Marigona Ukaj shpall të pavlefshëm dëftesat e kl. X, XI, XII dhe diplomën e SH.M.M. Mjekësis "Hysni Zajmi" Gjakovë.

► Shkëlqim Arifi shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Dilë Gjonaj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. Ukshin Miftari k Gjakovë.

► Andi Xhoci shpall të pavlefshme certifikatën e maturës të SH.M.E. "Kadri Kusari" Juridik në Gjakovë.

► Nevruz Derri shpall të pavlefshme defyesën e plotë të SH.F. "Yll Morina".

► Besian Pozhegu shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII Diplomën dhe certifikatën e testit të maturës të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Orest Dermishishpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Zeqirja Gjoni shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike Tekstili "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

